

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR. 302 REP.

NR. 126 KOL.



MARREVESHJE TRANSFERIMI TE BIZNESIT

Sot, me date 28 Janar 2019 (dymije e nentembedhjete), perpara meje, Noteres Publike **Amela Q. MUKAJ**, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me zyrc ne adresen: Bulevardi Blu, Godina "Arben Dedja", Kati 2-te, u paraqiten personalisht palet e meposhtme per te lidhur kete marreveshje:

Shoqeria "MAK ALBANIA" sh.p.k, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar dhe ekzistuese sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit Shqiptar me NIPT **J61821059A**, me seli ne adresen: Njesia Bashkiake Nr.5, Sheshi Italia, Ambienti me Nr.pasurie 7/57, Zona Kadastrale 8160 Tirane, Shqiperi, me kapital themeltar 11.238.757.236 Leke (njembedhjete miliarde e dyqind e tridhjetete e tetemilion e shtateqind e pesedhjetete e shtatemije e dyqind e tridhjetete e gjashte), perfaqesues I autorizuar me Vendim te Asamblese se Ortakat te Vetem Nr.328, date 16.01.2019, **Z.Elsi KEKO**, shtetas shqiptar, I biri I Gezimit, I datelindjes 12.12.1977, lindur ne Baban, Devoll dhe banues ne Tirane, mbajtes I Leternjofimit (ID) Nr. 029715352 dhe numer personal Nr. H71212101T, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, (ne vazhdim referuar si "**Shites**").


Dhe

Shoqeria "KASTRATI RESIDENCES" sh.p.k, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar dhe ekzistuese sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit Shqiptar me NIPT **L91315035G**, me seli ne adresen: Njesia Bashkiake Nr.5, Sheshi Italia, Ambienti me Nr.pasurie 7/60, Zona Kadastrale 8160 Tirane, Shqiperi, me kapital themeltar 100.00 Leke (njeqind leke), e perfaqesuar nga njeri nga Ortaket e Shoqerise I autorizuar me Vendim te Asamblese se Ortakeve Nr.02, date 16.01.2019, **Z. Musa KASTRATI**, shtetas shqiptar, i biri i Shefqetit, i datelindjes 28.12.1992, lindur ne Krume, Has dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Leternjofimit (ID) Nr.027176432 dhe numer personal Nr.J21228058F, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, (ne vazhdim referuar si "**Bleres**").

Secila prej subjekteve te siperpermendura do t'i referohemi si "Pale", dhe bashkarisht atyre do t'u referohemi si "Palet".

MEQENESE

- A. Veprimtaria kryesore e Shitesit eshte zhvillimi i aktiviteteve tregtare ne fushen e ndertimeve te ndryshme me karakter turistik, industrial social, ndertim banesash etj. gjithashtu veprimtari tregtare te import eksportit, turizmit, veprimtari ndertuese, administruese, manaxhuese te nje hoteli turistik te nje niveli te larte dhe te hoteleve te tjera ne te ardhmen etj.
- B. Ne varesi te tormave dhe sipas kushteve te kesaj Marreveshjeje, Shitesi deshiron te shese dhe te transferoje Biznesin (nje pjese te tij siq percaktohet ne detaje me poshte) si nje biznes i vazhdueshem ndaj Bleresit dhe Bleresi deshiron te bleje dhe te marre Biznesin nga Shitesi, sipas kushteve te percaktuara ketu:



C. Bleresi ne vazhdim deshiron te bleje nga Shitesi, sipas kushteve te kesaj marreveshje ndertesat e Shitesit dhe pronat e tjera ne ate mase qe ato jane te nevojshme per Bleresin per te kryer Biznesin qe po blen nga Shitesi sipas kesaj Marreveshjeje.

D. Bleresi dhe Shitesi kane rene dakord te ndermarrin detyrimet e parashikuara ketu.

ATEHERE, duke marre parasysh perfitimet dypaleshe dhe perfaqesimin e garancive, kushteve dhe premtimeve te percaktuara ne kete dokument, brenda kufizimeve ligjore, Palet bien dakord si vijon:

NENI 1

PERKUFIZIME

Siç perdoret ne kete Marreveshje, termat e mposhtem do te kene kuptimin e percaktuar ose te permendur me poshte.

- Marreveshjet** do te thote te gjitha marreveshjet, kontratat e konsumatoreve, nenkontraktoret, furnizimi, reklamimi, promovimi, menaxhimi, sherbimi, perfitimi, mirembajtja, ndertimi, riparimi, qirate dhe kontratat ose marreveshjet e tjera, duke perfshire qirate e pajisjeve te kapitalizuara per qellime te kontabilitetit dhe çdo ndryshim, ne lidhje me pronesine, mirembajtjen dhe funksionimin e Biznesit, si dhe garancite e shkruara qe lidhen me to, siç jane te listuara ne Shtojcen 2, duke perjashtuar te gjitha marreveshjet financiare.
- Asetet** do te thote Pasurite e Paluajtshme, Pronen e Prekshme Personale, Te Drejtat e Pronesise Intelektuale, pasurite e paluajtshme, njohurite dhe te gjitha pasurite e tjera qe lidhen me Biznesin qe Shitesi zoteron;
- MTB** nenkupton kete Marreveshje per Transferimin e Biznesit;
- Mbyllje** nenkupton percaktimin ne nenin 6.1 ne kete MTB;
- Data e mbylljes** nenkupton percaktimin ne nenin 6.1 ne kete MTB;
- Biznes** do te thote biznesi i Shitesit per Zhvillimin e aktiviteteve tregtare ne fushen e ndertimeve te ndryshme me karakter turistik, industrial social, ndertim banesash etj. gjithashtu veprimtari tregtare te import eksportit, turizmit, veprimtari ndertuese , administruese, manaxhuese te nje hoteli turistik te nje niveli te larte dhe te hoteleve te tjera ne te ardhmen etj nen emrin e "MAK ALBANIA", qe perfshin te gjitha komponentet e percaktuara ne nenin 3 te kesaj MTB;
- Punonjesit** nenkupton, kolektivisht, te gjithe punonjesit e Shitesit qe punojne me kohe te plote ose me kohe te pjesshme per Biznesin ne çdo kohe te caktuar. Per qellime informacioni, Shtojca 4 percakton Listen e Punonjesve ne Daten e Nenshkruar;
- Kontrata e punonjesit** nenkupton kontraten e punes midis Shitesit dhe Punonjesve;
- Barra** nenkupton çdo hipoteke, barre, peng, hipoteke, depozite me ane te sigurimit, barre, mundesi, mbajtje titulli, uzufuktim, zevendesimi, e drejta e refuzimit te pare ose barra te tjera te ngjashme apo interesa te sigurise te çfaredo lloji; nje kerkesë, marreveshje, rregullim ose detyrim per te krijuar ndonje nga sa permendet mesiper;



Çmimi i Blerjes nenkupton percaktimin ne nenin 4.1 ne kete MTB;

Pasuri e paluajtshme nenkupton pronat dhe ndertesat qe perdoren nga Shitesi per te kryer Biznesin e vendosur ne Sheshi Italia, detajuar ne shtojcen 1;

NENI 2

SHITJA DHE BLERJA E BIZNESIT


2.1 Sipas Kushteve dhe subjekt i ketyre kushteve te kesaj MTB, Shitesi ben shitjen dhe ne perputhje me Kushtet Paraprake, do te transferoje ne Mbyllje per Bleresin, dhe Bleresi ne kete menyre blen, dhe merr dorezimet nga Shitesi ne Mbyllje, Biznesin te lire nga te gjitha Barrat. Me ane te marrjes dhe zoterimit te Biznesit, Bleresi perveteson nga Shitesi te gjitha Pronat e Paluajtshme te dakorduara dhe te gjitha Stokun qe kane lidhje me Biznesin. Si rezultat i blerjes se Biznesit, te gjitha Marreveshjet dhe te gjitha Punonjesit qe punojne per Biznesin ne Mbyllje do te transferohen tek Bleresi ne Daten e Mbylljes ashtu si percaktohet ne te. Me tej, nenkuptohet qe Bleresi nuk merr asnje detyrim te Shitesit pervec atyre te percaktuara ne Nenin 3 dhe asnje detyrim tjeter vec atyre te percaktuar ne Nenin 3 nuk do te merret ose nenkuptohet si i marre nga Bleresi.

2.2 Detyrimet e Paleve per te kompensuar ligjerisht transakcionet e parashikuara nga kjo MTB, do te jene subjekt i permbushjes se Kushteve paraprake sic percaktohet ne Nenin 5.1.

NENI 3

BIZNESI

- 3.1 Biznesi qe Shitesi do t'i transferoje Bleresit ne Mbylljen nen kete MTB do te perbehet nga:
- Pasurite, qe perfshijne: Pasurite e paluajtshme nen pronesine e shitesit, duke perfshire tokat qe jane te lidhura me kete biznes (Shtojca 1);
 - Marreveshjet e renditura ne (Shojcen 2);
 - Inventarin e AQT (Shtojca 3);
 - Punonjesit qe punojne me orar te plote dhe/ose me kohe te pjesshme per Biznesin qe transferohet (Shtojca 4)
- 3.2 Palet bien dakord qe Biznesi te transferohet pa para Cash dhe pa Borxhe.
- 3.3 Per shmangien e cdo dyshimi, pervec nese parashikohet ndryshe ne kete MTB, Shitesi eshte pergjegjes dhe do te paguaje dhe shlyeje ne kohe dhe ne menyre te perpikte te gjitha Borxhet, tatimet dhe detyrimet e tjera qe lidhen me Biznesin per periudhen deri ne Daten e Mbylljes duke perfshire, pa kufizim, te gjitha detyrimet, Borxhet (duke perfshire cdo kredi afatshkurter dhe afatgjate dhe te gjitha borxhet e tjera ne bilancin e biznesit ne Daten e Mbylljes), tatimet dhe detyrime te tjera qe lidhen me biznesin, te cilat i referohen periudhes deri ne Daten e Mbylljes, nese borxhet e tilla, tatimi, obligimet ose detyrimet tjera jane maturuar ose jo para Mbylljes ose do te maturohen ose lindin pas Mbylljes.
- 3.4 Shitesi do te jete ne menyre te pakufizuar pergjegjes per te paguar te gjitha detyrimet dhe Borxhet ndaj Punonjesve deri ne Daten e Mbylljes pa asnje kufizim, pervec rasteve te percaktuara ndryshe ne kete MTB, paga, kompensime, bonusit i fund vitit, rimbursimet, shperblimet, nese ekzistojne duke perfshire taksat.



Taksa e pulles u pagua
Shitesi merr persiper te paguaje te gjitha shpenzimet qe lidhen me Punonjesit ne kohen e duhur ne lidhje me punesimin e tyre te Shitesi deri ne Daten e Mbylljes, si dhe ato qe duhet te kryhen pas Dates se Mbylljes dhe ato qe kane te bejne me nderprerjen e punesimit te tyre ne Mbylljen.

NENI 4

ÇMIMI I BLERJES DHE PAGESA

- 4.1 Transferimin e Biznesit ('Çmimi i Blerjes') do te kryhet per shumen zero leke. Ky cmim eshte rezultante e vleres se aseteve qe do te transferohen per shumen 1,488,883,330 Leke minus vleren e kapitalit qe do te transferohet tek shoqeria "KASTRATI RESIDENCES" sh.p.k,ne vleren prej 1,488,883,330 Leke.
- 4.2 Palet konfirmojne qe çmimi i blerjes perfshin çdo takse ne lidhje me shitjen dhe transferimin e ndonje prej Aseteve te perbere nga biznesi.
- 4.3 Palet e kesaj marreveshjeje bien dakord qe kjo marreveshje te depozitohet ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Tirane, ne momentin e nenshkrimit te kesaj marreveshjeje, me qellim kalimin e pronesise ne favor te pales blerese .

NENI 5

KUSHTET PARAPRAKE

- 5.1 Detyrimet e paleve per te kryer Veprimet e Mbylljes siç percaktohet ne Nenin 6 me poshte, do te jene subjekt dakordesimi, dhe do ti nenshtrohen, siç percaktohet ne Nenin 6.2 te te gjitha kushteve te referuara me poshte (me poshte Kushtet paraprake):
 - i. Njoftimi i te gjitha paleve te treta qe preken nga kjo Marreveshje. Transferimin e te gjitha kontratave te qirave per ambientet te cilat po transferohen.
 - ii. Miratimet e duhura te organeve te Shoqerise per te transferuar Biznesin i jane dhene Shitesit ne perputhje me Nenet e Statutit ("Kushti i Aprovimit te Ortakeve");
 - iii. Shitesi duhet ta njoftoje MTB tek autoritetet perkatese tatimore kompetente 45 dite para se transakcioni te ndodhe;
 - iv. Punonjesit jane njoftuar per transferimin e Biznesit tek Bleresi ne perputhje me ligjin e punes dhe te gjitha detyrimet qe rrjedhin prej tyre jane permushur.
- 5.2 Palet jane te detyruara te bejne perpjekjet me te mira per te permushur Kushtet Paraprake sa me shpejt qe te jete e mundur. Bleresi, ndermjet dates se nenshkrimit dhe dates se mbylljes, perditeson rregullisht Shitesin per çdo perparim te bere ne lidhje me permushjen e detyrimeve te Bleresit ne lidhje me Kushtet Paraprake te percaktuara ne Nenin 5.1.
- 5.3 Menjehere pasi te jete permushur nje nga Kushtet Paraprake ose ne rast se paraqiten rrethana kercenuese qe mund te pengojne permushjen e Kushteve Paraprake, Palet do te informojne njera-tjetren menjehere. Secila nga Palet ka te drejte te kerkoje nga Pala tjetere perkatese qe te ofroje çdo informacion qe konsiderohet i nevojshem per te, per te shqyrtuar dhe monitoruar nese nje ose me shume Kushte Paraprake jane permushur ose ende mund te permushen. Secila Pale do t'i siguroje Pales tjetere perkatese te gjitha informacionet dhe dokumentet e kerkuara.



NENI 8

MARREVESHJE PER PERIUDHEN PAS MBYLLJES

- 8.1 Bleresi, qe nga Data e Mbylljes, kryen te gjitha detyrimet si punedhenes ne lidhje me Punonjesit sic parashikohet nga ligji.
- 8.2 Ne vazhdim asetet, librat, regjistrimet, qe lidhen me Biznesin e transferuar tek Bleresi ne Daten e Mbylljes, Shitesi duhet te siguroje qe origjinalet e ketyre librave dhe regjistrimeve ose mjeteve te tilla qe mungojne duhet t'i dorezohen Bleresit ne kohen e duhur.

NENI 9

PERFAQESIMET DHE GARANCITE NGA SHITESI

- 9.1 Shitesi i paraqet Deklarimet dhe Garancite e meposhtme si te specifikuara ne nenin 9 (9.2 deri ne 9.6) te kesaj MTB (ne tekstin e meposhtem "Garancite e Shitesit"), ne daten e nenshkrimit dhe direkt para Data e Mbylljes.
- 9.2 Autorizimi dhe Qendrimi
- (i) Shitesi ka kapacitet te plote, fuqi dhe autoritet per te ekzekutuar, dorezuar dhe kryer kete MTB dhe per te perfunduar transakcionet e parashikuara, dhe ka ndermarre te gjitha veprimet e nevojshme per ekzekutimin dhe dorezimin dhe per te ushtruar te drejtat e tij dhe per te kryer detyrimet e tij sipas kesaj MTB.
 - (ii) Shitesi ka marre te gjitha vendimet dhe veprimet e tjera te shoqerise ose veprime te nevojshme per ekzekutimin, dorezimin dhe kryerjen e te gjitha detyrimeve te Shitesit te parashikuar ne kete MTB dhe per t'i bere keto dispozita te detyrueshme dhe te zbatueshme mbi Shitesin.
 - (iii) Ortaket e Shitesit qe e miratojne kete MTB jane ortaket e vetem te Shitesit.
 - (iv) Kjo MTB paraqet detyrime ligjore, te vlefshme dhe detyruese te Shitesit, te zbatueshme ne perputhje me kushtet e saj.
 - (v) Shitesi gezon aftesine paguese, ne kuptim te ligjit per falimentimin e detyrueshem, cka do te thote se Shitesi nuk eshte, as: a) ne pamundesi afatgjate paguese, dhe as b) jolikuid ne menyre te vazhdueshme. Nuk ekziston asnje situat e pazgjidhur falimenti, gjendje e nje pamundesie per te paguar, likuidimi apo procedure e ngjashme (qofte kjo e detyrueshme apo vullnetare), si dhe nuk eshte bere apo ngritur asnje kerkese per nje procedure te tille, qe ka lidhje me Shitesin apo Biznesin.
 - (vi) Shitesi eshte pronar i vetem dhe ekskluziv i ligjshem i Biznesit, Pasurive te Paluajtshme ;
 - (vii) Ekzekutimi dhe dorezimi i kesaj MTB dhe perfundimi i transakcioneve te parashikuara nga Shitesi, me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe, nuk kerkojne pelqimin ose miratimin e ndonje Autoriteti Qeveritar ose Rregullator, dhe as ekzekutimi dhe dorezimi nuk do te rezultojne ne nje shkelje te ndonje ligji, (ose nje ngjarje qe me paralajmerim dhe kalim kohe, ose te dyja, do te perbeje nje vonese) sipas ndonje kontrate ose marreveshjeje ne te cilen Shitesi ose Biznesi eshte pale ose me te cilen ai ose prona e tij eshte e lidhur.

9.3 Biznesi




- (i) Biznesi është i transferueshem lirshem dhe pa barra qe mund te ndikojne ne disponueshmerine dhe realizimin e saj dhe menjehere pas Mbylljes, Bleresi do te kete titull tregtar per te gjitha pasuritë, te lira dhe te pastra nga çdo barre.
- (ii) Shitesi ka marre pelqimin e ortakeve te tij per ekzekutimin e kesaj MTB, siç kerkohet sipas Neneve te Statutit te saj.
- (iii) Te gjitha librat dhe dokumentat e Shitesit (perfshire dokumentat fiskale dhe te kontabilitetit) jane mbajtur ne perputhje me ligjet ne fuqi, standardet e aplikueshme te kontabilitetit dhe ne perputhje me praktikat e kaluara, dhe pasqyrojne materialisht te gjitha transaksionet qe kerkohet te pasqyrohen sipas ligjeve ne fuqi dhe sipas parimeve te aplikueshme te kontabilitetit. Keto Libra dhe regjistra i jane vene ne dispozicion Bleresit para dates se ketij dokumenti.

9.4 Punonjesit

- (i) Shitesi ka permbushur dhe paguar te gjitha detyrimet e sigurimeve shoqerore dhe tatimore lidhur me Punonjesit siç kerkohet sipas ligjeve dhe nuk eshte perfshire ne praktike te paligjshme pune te asnje natyre. Shitesi nuk ka (i) zbatuar asnje pjesemarrje fitimi, kapital ose plane te tjera te perfitimeve te punonjesve, ose (ii) ka dhene, drejtperdrejt ose terthorazi, ndonje hua per aksioneret, drejtuesit, zyrtaret ose punonjesit, ose (iii) ka lidhur ndonje marreveshje ose mirekuptim me asnje punonjes te Shitesit, i cili do t'i siguronte seciles prej tyre ndonje pretendim per ndonje trajtim preferencial ose perfitime te tjera ekonomike jashte marreveshjeve te rregullta te punesimit, nese do te ekzistonte nje e tille, do te sillte shpenzim ose detyrim kundrejt te ardhurave te Shitesit.
- (ii) Kontratat e Punesimit jane ne fuqi, te vlefshme dhe te zbatueshme ne perputhje me termat dhe kushtet e tyre dhe ne perputhje me ligjet ne fuqi dhe marreveshjet kolektive te negociatave. Nuk ka forma te tjera te shperblimit dhe / ose perfitim per Punonjesit, pervec atyre te deklaruarat dhe te parashikuara ne Kontratat e Punes dhe / ose ne marreveshjet kolektive ne fuqi me Punonjesit.
- (iii) Deri ne dhe duke perfshire Daten e Mbylljes, Shitesi nuk ka shkelur ndonje dispozite te ndonje prej Kontratave te Punes dhe ka permbushur te gjitha detyrimet e tij si punedhenes sipas ligjeve.

9.5 Marreveshjet

- (i) Marreveshjet jane ne fuqi, te vlefshme dhe te zbatueshme ne perputhje me termat dhe kushtet e tyre, dhe as Shitesi as ndonje nga palet nuk jane ne kundershtrim me to.
- (ii) Palet perkatese kontraktuale kane kryer obligimet e tyre sipas Marreveshjeve. Nuk ka arsye per shfuqizimin, shmangien ose mohimin e ndonje Marreveshjeje dhe nuk ka baza per kerkesa per humbje si rezultat ose ne lidhje me performancen e Shitesit.
- (iii) Palet kontraktuale kane miratuar ose do te miratojne transferimin e Marreveshjeve ne Mbyllje.
- (iv) Asnje nga palet kontraktuese nuk kane dhene njoftim me shkrim per te nderprere ose kercenuar te nderpresin ndonje nga Marreveshjet dhe asnje klient, furnizues ose shites nuk i ka dhene shitesit njoftimin se synon te nderprese ose te zvogeloje ndjeshem blerjet e tyre aktuale.

9.6 Taksat

- (i) Shitesi ka respektuar te gjitha aspektet materiale me ligjet tatimore.



- (ii) Te gjitha shenimet e duhura jane mbajtur dhe te gjitha kthimet dhe pagesat e duhura jane bere siç kerkohet me ligj per qellime te TVSH-se.
- (iii) Shitesi ka dorezuar ne kohe dhe ne menyre te duhur te gjitha deklaratat tatimore dhe te gjitha dokumentet e tjera te lidhura me tatimet qe u eshte kerkuar te dorezojne ne kohen e duhur me autoritetet perkatese tatimore ne perputhje me ligjet ne fuqi dhe i ka paguar te gjitha taksat e paraqitura ne afatin e duhur; Shitesi nuk ka hequr dore nga ndonje statut kufizimi ne lidhje me tatimet ose eshte pajtuar me ndonje zgjatje te kohes ne lidhje me ndonje vleresim ose mangesi tatimore; dhe, me perjashtim te rasteve kur cilesohet ndryshe, nuk ka ne pritje asnje auditim, ekzaminim, mangesi ose çeshtje gjyqesore te çfaredo lloji ne lidhje me ndonje takse dhe asnje autoritet tatimor nuk ka dhene njoftim me shkrim per qellimin per te filluar ndonje shqyrtim, auditim apo proces gjyqesor te tille. Te gjitha dokumentet lidhur me tatimet, te kerkuara per t'u pergatitur, jane te verteta, te plota dhe korrekte ne te gjitha aspektet materiale.

NENI 10

PERFAQESIMET DHE GARANCITE NGA BLERESI

Bleresi i paraqet Shitesit Perfaqesimet dhe Garancite (me tej "Garancite e Bleresit"), si ne Daten e Nenshkrimit dhe direkt para Dates se Mbylljes, perveç rasteve te cilesuara ndryshe, te cilat te mbijetoje per nje periudhe tre (3) vite nga Data e mbylljes:

- i. Bleresi ka kapacitet te plote, fuqi korporate dhe autoritet per te ekzekutuar, dorezuar dhe kryer kete MTB dhe per te perfunduar transaksionet e parashikuara ne kete menyre dhe ka burime te mjaftueshme financiare per te paguar Çmimin e parashikuar te Blerjes sipas kushteve te kesaj MTB.
- ii. Bleresi gezon aftesine paguese ne kuptim te ligjit te falimentimit, qe do te thote se Bleresi nuk eshte (a) ne pamundesi afatgjate pagues (b) jolikuid ne menyre te vazhdueshme.
- iii. Kjo MTB, pasi te jete ekzekutuar siç duhet nga Bleresi, do te perbeje detyrime ligjore, te vlefshme dhe detyruese te Bleresit, te zbatueshme ndaj Bleresit ne perputhje me kushtet e saj.

NENI 11

KOSTOT, TAKSAT DHE PAGESAT

- 11.1 Secila pale do te barte shpenzimet e veta, shpenzimet e bera ne lidhje me te gjitha çeshtjet qe kane te bejne me pergatitjen, negocimin dhe zbatimin e kesaj MTB dhe transaksionet e parashikuara me ane te kesaj. Tarifat e personave te trete, duke perfshire pa kufizim avokatet, kontabilistet, agjentet dhe keshilltaret financiare te ruajtur nga cilado nga Palet e kesaj Marreveshjeje, do te jene respektivisht per llogari te çdo Pale.
- 11.2 Çdo tarife dhe detyrim, si dhe shpenzimet e tjera per dosjet administrative dhe formalitetet, si dhe tarifate dhe noterit qe lidhen me dhe / ose ne origjine ose qe rrjedhin nga transferimi i Biznesit, do te ndahen ne gjysmen ndermjet Shitesit dhe Bleresit.
- 11.3 Taksat e transferimit, tatimi mbi vleren e shtuar ose ndonje takse tjeter shtese, transferimi ose vule ose pagesa te ngjashme, si rezultat i ndonje prej transaksioneve te parashikuara nga kjo MTB, do te ndahen midis shitesit dhe bleresit.



NENI 12

NJOFTIME

12.1 Te gjitha njoftimet komunikimet dhe deklaratat qe behen ne perputhje me ose ne lidhje me kete MTB do te behen me shkrim ne gjuhen shqipe dhe do te dergohen Paleve te tjera ne adresat dhe te shenuara per vemendjen e personave, te percaktuar ne Nenin 12.2.

12.2 Dergesat per Palet do te behen (ne varesi te ndonje ndryshimi te njoftuar me shkrim Paleve te tjera) ne adresat e meposhtme:

– **Per Shitesit:**

Shoqeria "MAK ALBANIA" sh.p.k

Njesia Bashkiake Nr.5, Sheshi Italia, Ambienti me Nr.pasurie 7/57, Zona Kadastrale 8160 Tirane, Shqiperi

Z. Elsi KECO

– **Per Bleresin:**

Shoqeria "KASTRATI RESIDENCES" sh.p.k

Njesia Bashkiake Nr.5, Sheshi Italia, Ambienti me Nr.pasurie 7/60, Zona Kadastrale 8160 Tirane, Shqiperi

Z.Musa KASTRATI

NENI 13

LIGJI ZBATUESHEM DHE ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

13.1 Ligji i Zbatueshem

Kjo MTB dhe te gjitha te drejtat dhe detyrimet kontraktuale qe rrjedhin nga ose ne lidhje me to, do te rregullohen dhe interpretohen ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise.

13.2 Zgjidhja e mosmarreveshjes

Çdo mosmarreveshje qe lind nga ose ne lidhje me kete MTB, perfshire dyshim ne lidhje me ekzistencen, vlefshmerine ose perfundimin e saj, do t'i referohet dhe perfundimisht do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.


NENI 14

TE NDRYSHME

14.1 Kjo Marreveshje perfshin miratimin e plote te Paleve mbi permbajtjen e kesaj MTB dhe zevendeson te gjitha miratimet dhe marreveshjet paraprake me goje ose me shkrim ne lidhje me permbajtjen e saj.

14.2 Ndryshimet dhe modifikimet e kesaj MTB dhe mospranimi i mundshem i te drejtave te specifikuar ne kete MTB jane te vlefshme vetem nese nenshkruhen ne forme te shkruar dhe nenshkruhen nga te dy Palet.



14.3 Titujt e Neneve dhe Nen-Nenet e kesaj MTB perdoren vetem per qellim te thjeshtezimit te referencave dhe nuk kane ndikim ne permbajtjen, kuptimin ose interpretimin e ndonje prej dispozitave te kesaj MTB. Te gjitha referencat per dispozitat ligjore perfshijne ndryshimet e mundshme ligjore dhe modifikimet para dates se kesaj MTB ose me pas. Palet kane marre pjese bashkerisht ne negociimin dhe hartimin e kesaj Marreveshjeje. Çdo rregull i ndertimit ose interpretimi qe kerkon interpretim ose ndertim ndryshe te kesaj Marreveshje nga ndonje pale ne baze te autoresise se kesaj Marreveshjeje, nuk do te zbatohet per ndertimin dhe interpretimin e kesaj Marreveshjeje.

14.4 Nese ndonje e drejte ose dispozite ose mjet juridik qe rrjedh nga ose ne perputhje me kete MTB nuk thirret ose nuk realizohet nga asnje Pale ne asnje kohe apo ne asnje periudhe, nuk nenkupton heqjen dore nga dispozita ose e drejta apo mjet juridik dhe nuk ndikon ne te drejten e Pales per ta realizuar ose per ta thirrur ate me vone, me kusht qe kjo e drejte te skadoje, deshtoje ose te hiqet. Heqja dore nga e drejta eshte e vlefshme vetem nese eshte nenshkruar ne forme te shkruar dhe eshte nenshkruar nga Pala qe heq dore.

14.5 Nese ndonje nga dispozitat e kesaj MTB eshte e pavlefshme ose e pazbatueshme nuk ka ndikim ne vlefshmerine ose ekzekutimin e dispozitave te tjera te MTB. Kjo MTB nenshkruhet ne 5 (pese) kopje, secila Pale merr nje kopje. Palet bien dakord qe dorezimi i kesaj Marreveshjeje dhe i çdo marreveshjeje dhe dokumenti tjetër ne Mbyllje mund te behet permes shkembimit te nenskrimeve me facsimile dhe duke derguar kopjet origjinale me korrier ose poste, ne vazhdim.

* * *

NE DESHMI TE KESAJ, palet bejne qe Marreveshje te ekzekutohet nga perfaqesuesit e tyre te autorizuar ne daten e shkruar me pare ketu. Marreveshja u perpilua nga une noteri/ja ne 5 (pese) kopje me vlere te pjejte ligjore, ju lexua paleve me ze te larte dhe qarte ne gjuhen Shqipe, u kuptua prej tyre dhe meqenese shpreh vallnetin e tyre te lire dhe te plote e nenshkruan ate perpara meje dhe une e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE

AMELA Q. MUKAJ

PALA BLERESE :

KASTRATI RESIDENCES sh.p.k

Musa KASTRATI

Musa Kastrati



PALA SHITESI:

MAK ALBANIA sh.p.k

Elsi KEÇO


Elsi Keco



SHTOJCA I

PASURIA E PALUAJTSHME NE PRONESI TE SHITESIT QE DO TE TRANSFEROHET

- "Njesi" e ndodhur ne Tirane, Njësia Bashkiake Nr.5, Sheshi Italia, Ambienti me Nr.pasurie 7/59, Zona Kadastrale 8160 Tirane, me sipërfaqe totale 765 (shtateqind e gjashtedhjetë e pesë) m², nga e cila Truall 765 (shtateqind e gjashtedhjetë e pesë) m², ndërtesë 45 (dyzet e pesë) m², e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 8160, Vol.49, Fq. 107, e pajisur me Certificate per Vertetim Pronesie Nr.1635317, me date leshimi 07.12.2018 (sipas ZVRPP Tirane).
- "Njesi" e ndodhur ne Tirane, Njësia Bashkiake Nr.5, Sheshi Italia, Ambienti me Nr.pasurie 7/60, Zona Kadastrale 8160 Tirane, me sipërfaqe totale 14 228 (katëmbëdhjetëmijë e dyqind e njetzet e tete) m², nga e cila Truall 14 228 (katëmbëdhjetëmijë e dyqind e njetzet e tete) m², ndërtesë 2 561 (dymijë e pesëqind e gjashtedhjetë e një) m², e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 8160, Vol.49, Fq. 108, e pajisur me Certificate per Vertetim Pronesie Nr.1635318, me date leshimi 07.12.2018 (sipas ZVRPP Tirane).
- "Njesi" e ndodhur ne Tirane, Njësia Bashkiake Nr.5, Sheshi Italia, Ambienti me Nr.pasurie 7/61, Zona Kadastrale 8160 Tirane, me sipërfaqe totale 828 (teteqind e njetzet e tete) m², nga e cila Truall 828 (teteqind e njetzet e tete) m², ndërtesë 4 (kater) m², e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 8160, Vol.49, Fq. 109, e pajisur me Certificate per Vertetim Pronesie Nr.1635313, me date leshimi 07.12.2018 (sipas ZVRPP Tirane).
- "Njesi" e ndodhur ne Tirane, Njësia Bashkiake Nr.5, Sheshi Italia, Ambienti me Nr.pasurie 7/62, Zona Kadastrale 8160 Tirane, me sipërfaqe totale 1 980 (njëmijë e nenteqind e tetëdhjetë) m², nga e cila Truall 1 980 (njëmijë e nenteqind e tetëdhjetë) m², ndërtesë 720 (shtateqind e njetzet) m², e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 8160, Vol.49, Fq. 110, e pajisur me Certificate per Vertetim Pronesie Nr.1635314, me date leshimi 07.12.2018 (sipas ZVRPP Tirane).
- "Njesi" e ndodhur ne Tirane, Njësia Bashkiake Nr.5, Sheshi Italia, Ambienti me Nr.pasurie 7/63, Zona Kadastrale 8160 Tirane, me sipërfaqe totale 3 119 (tremijë e njëqind e nentëmbëdhjetë) m², nga e cila Truall 3 119 (tremijë e njëqind e nentëmbëdhjetë) m², ndërtesë 454 (katerqind e pesëdhjetë e kater) m², e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 8160, Vol.49, Fq. 111, e pajisur me Certificate per Vertetim Pronesie Nr.1635315, me date leshimi 07.12.2018 (sipas ZVRPP Tirane).





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

1635317

Z.V.R.P.P. TIRANË

Zyra e Regjistrimit _____ Zona Kadastrale Nr. 8160

Numri i Pasurisë 7/59 Volumi 49 Faqe 107

Adresa e Pasurisë TIRANË

Lloji i Pasurisë TRUALL

Sipërfaqja Totale 765.00 m²

Nga kjo : Sa Truall 765.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa 45.00


Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
"MAK ALBANIA"	SH.P.K		1/1	TIRANË
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____

- është pronar i _____ pasurisë me numër 7/59
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart _____
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
- kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____



Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 12/2018 Nr. 10152

Data e lëshimit të certifikatës

7/12/2018

Lëshues i certifikatës
REGJISTRUESI

ELION SEMAJ



5 - SHKËRTIMI I TITULLIT TË PASURISË

Titulli i pasurisë: _____
 Adresa e pasurisë: _____

Ref. _____ PJG _____ SUI _____ K _____ Ap _____


Përkrahur i vokatit
 VUJON NGA VDI 48/PQ 2002

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N. : PO Ref. PI. _____
RREGULL

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale sa Truall	Nga Sip. Truallt sa Ndertes
1. <u>765.00</u> m ² Ref. <u>00019664</u>	1. <u>765.00</u> m ² Ref. <u>00019664</u>	1. <u>45.00</u> m ² Ref. <u>00019664</u>
2. _____ m ² Ref. _____	2. _____ m ² Ref. _____	2. _____ m ² Ref. _____
3. _____ m ² Ref. _____	3. _____ m ² Ref. _____	3. _____ m ² Ref. _____
4. _____ m ² Ref. _____	4. _____ m ² Ref. _____	4. _____ m ² Ref. _____

Per pjesen e perbasniket:
PALLAT
 Kuota e pjeses: _____
 Nr i Pasurise (pallat): _____
 Voli _____ Faqe _____



C - SEKSIONI I PRONESISE


Nr. Dok	Data Regjistrimit	Emri	Adresa	Mbiemri	Nr. Pasap	I/V/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Certifikates	Shënimet	Firma
00019664	07/12/2018	"MAK ALBANIA" SH.P.K.				1	TIRANE		07/12/2018	ND PAS	



NO. DOK.	DATA REGISTRIMIT	TYP	PËRSHKRITJA	DATA E LËSH CERTIFIKATËS	SHËNIME	FIRMA

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Registrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh Certifikatës	Shënime	Firma



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E DREJTËSISË
 ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJFTSHME
 ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJFTSHME
 Adresë: Rruga Jordan Misja, Tiranë

TIRANË, më 7 / 12 / 2018



SHËNIM: Kjo kopje është e vërtetë dhe origjinalin e adehur në zyrën tona
 Në regjistrin Vol. 49 / 2018 / 107, Zona Kadastrale 8160, Qyteti Tiranë



HARTA VERQESË E REGJISTRIMIT
(Fragment)

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
TIRANË

A IDENTIFIKIMI I PASURISË
 ZONA KADASTRALE 8160 PASHTRIN 7/59 VOLUME 44 TË 101
 DIMENSIONALITETI 7/61 1/1000
 ADRESA E PASURISË TË REGISTRUARË TIRANË
 Rr/L _____, PG _____, Sh _____, K _____, Ap _____
 B. KUFIZIMET C. PRONARI
 V. 7/20
 L. 7/61 MAE-ALBANIA
 I. 7/60 SH.P.C
 P. 7/60
 D. Data: _____ / _____ / 2018, Ora _____, Puncti: _____





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

1635314


Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. TIRANË Zona Kadastrale Nr. 8160
 Numri i Pasurisë 7/62 Volumi 49 Faqe 110
 Adresa e Pasurisë TIRANË
 Lloji i Pasurisë TRUALL
 Sipërfaqja Totale 1980.00 m²
 Nga kjo : Sa Trual 1980.00
 Nga kjo : Sa Ndërtesa 720.00
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %



KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
"MAK ALBANIA"	SH.P.K	-	1/1	TIRANË



- është pronar i pasurisë me numër 7/62
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V _____ L _____ J _____ P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 12/2018 Nr. 1635314

Data e lëshimit të çertifikatës
7/12/2018

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI

ELION SEMI
Z.V.R.P.P. TIRANË



V - SEKSIONI I DHEKËTIMIT I PASURISE

Adresa e Pasurisë: _____

Ref. _____ PG _____ Shtet _____ K _____ Ap _____

Përshkrim i veçantë

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Ujeji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N. : PO Ref. PL. _____

RREGULL

UES

Sip. Totale e Pasurise	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truallit: sa Ndëresë
1. <u>1.980.00</u> m ² Ref. <u>00019664</u>	1. <u>1.980.00</u> m ² Ref. <u>00019664</u>	1. <u>720.00</u> m ² Ref. <u>00019664</u>
2. _____ m ² Ref. _____	2. _____ m ² Ref. _____	2. _____ m ² Ref. _____
3. _____ m ² Ref. _____	3. _____ m ² Ref. _____	3. _____ m ² Ref. _____
4. _____ m ² Ref. _____	4. _____ m ² Ref. _____	4. _____ m ² Ref. _____

Për pjesën e përbutshme

PALLAT

Kuria e përcaktuar


Nr i Pasurise (pallat)

Vol _____ Faqe _____



C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr. Dok	Data Registrimit	Emri	Adresa	Mbientri	Nr. Pasap	I/E/H	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Esh. Qytetëzimit	Shënim	Firma
00019664	07/12/2018	"MAK ALBANIA" SH.P.K.				I	TIRANE		07/12/2018	NPPAS	



№. Dok.	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lirisë Çertifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

№. Dok.	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lirisë Çertifikatës	Shënime	Firma



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E DREJTËSISË
 ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
 ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
 Adresë: Rruga Jandën Mëso, Tiranë

TIRANË, më 7 / 12 / 2018

SHËNIM: Ky lehtëbërës është në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tuaj.
 Niveli i dokumentit është 110, Zona Kadastrore: 8100, Qyteti Tiranë



MAPA TREGUESË E REGJISTRIMIT

(Fragmenti)

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

A. IDRI (FUNKIMI) PASURISË

ZONA KADASTRALE 8160 NATURESË 7/62 VOL. 44 FG 110

NO. REGJISTRIMIT TR-T-12 SHALLI 1/1000

ADRESA PASURISË TË REGJISTRIMIT TIRANË

Rel. _____ PG _____ Sh _____ K _____ Ap _____

B. KUFIZIMET

C. PRONARI

V. 7/20


L. -

J. 7/63

P. 7/61

"MAK-ALBANIA" SH.P.K

D. Data: / / 2018, Ora _____, Punori: *[Signature]*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

1635313

Z.V.R.P.P. TIRANË

Zyra e Regjistrimit _____ Zona Kadastrale Nr. 8160

Numri i Pasurisë 7/61 Volumi 49 Faqe 109

Adresa e Pasurisë TIRANË

TRUALL

Lloji i Pasurisë _____

Sipërfaqja Totale 828.00 m²


